



GJYKATA E LARTË

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN (MEDIAN) DHE ME JASHTË

Tiranë, 16.11.2023

NJOFTIM PËR MEDIAN

Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë zhvilloi më datë 16.11.2023 procedurën për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të kësaj Gjykate.

Referuar kërkesave të nenit 26, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R.SH.” si dhe të vendimit Nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që parashikojnë zgjedhjen e zëvendëskryetarit nga rradhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pas procesit të verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për kandidaturën e paraqitur, në prani të gjyqtarëve dhe të ndihmësmagjistratëve të komanduar dhe me të drejtë vote, Mbledhja e Përgjithshme vijoi me kryerjen e procedurës së votimit.

Në përfundim, Z. Ilir Panda, rezultoi i zgjedhur me 25 vota, si Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.